

KERKESE PER KONSULTIM ME PUBLIKUN

Drejtuar: AKM-se Tirane
Per dijeni: DRM-se Fier

KOMPLEKS PULARIE ME LINJAT PERKATESE



*Instalimi – Kompleks pularie me linjat perkatese, bazuar ne shtojcen 1 te ligjit Nr. 52/2020 per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10 448, date 14.7.2011, “Per lejet e mjedisit”, te ndryshuar klasifikohet si aktivitet: **Blegtoria 7.8 a. Rritje intensive e shpendeve ne nje instalim Me kapacitet 40000–1000 (krere)vende shpendesh.***

Vendodhja: Fshati Mbyet, komuna Portez, Fier.

Zhvilluesi:

Subjekti “Hoxhaj” sh.p.k

Hyrje

Kerkesa per pjesmarrjen ne organizimin e konsultimit me publikun dhe palet e interesuara hartohet per aplikim per leje mjdisi tipi B, Blegtoria 7.8 a. Rritje intensive e shpendeve ne nje instalim Me kapacitet 40000–1000 (krere) vende shpendesh, bazuar kjo ne shtojcen 1 te ligjit Nr. 52/2020 per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10 448, date 14.7.2011, “Per lejet e mjedisit”, te ndryshuar.

Subjekti eshte i pajisur me akt-miratimi (S), leje mjedisore me Nr192/3 Prot, date 24.04.2013. Duke u bazuar ne rregullin qe te gjitha aktivitetet te cilat kane leje mjedisore para vitit 2014, lejet egzistuese dalin jashte funksionit dhe behet rinovimi i lejes se re sipas ligit te permendur me siper.

Ky aktivitet zhvillohet nga shoqeria “Hoxhaj” sh.p.k i regjistruar ne QKB, me numer NUIS K52614401B me fushe veprimtarie “Kompleks pularie me linjat perkatese”.

Vendodhja e pularise eshte ne fshatin Mbyet, Njesia administrative Portez, Bashkia Fier ne Zk 2637, me Nr. Pasurie 62/100, me siperfaqe $S=4519 \text{ m}^2$.



Objekti ndodhet ne jug te qytetit te Fierit, ne nje distance 1,2 km nga qendra e tij. Ai ndodhet ne fshatin Mbyet, ne ane te rruges se Plykut, Njesia Administrative Portez, Bashkia Fier. Rajoni ku zhvillohet kjo veprimtari nuk eshte i klasifikuar si rajon i ndotur dhe keshtu qe zhvillimi i saj nuk rendon apo

perqeqeson treguesit mjedisor te tij. Kemi te bejme me nje zone me zhvillim bujqesor, e cila konsumon te gjithë sasine e mbetjeve teknologjike (glasave) qe dalin ne perfundim te nje cikli rritjeje zogjsh. Zhvillimi i ketij aktiviteti, pajisjet dhe makinerite si dhe menyra e vendosjes se godinave, sistemi i hapsirave te pazena me ndertime, shesheve, rrugeve, etj. jane ne pershtatshmeri me kerkesat mjedisore te zones.

Koordinatat e objektit jane:



Nr	X (East)	Y (Nord)
Pika 1	4378673.16	4509894.14
Pika 2	4378699.92	4509950.39
Pika 3	4378686.05	4510008.98
Pika 4	4378576.32	4509954.75
Pika 5	4378619.28	4509879.99
Pika 6	4378665.42	4509910.27



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

1602226

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. FIER Zona Kadastrale Nr. 2637
 Numri i Pasurisë 62/100 Volumi 6 Faqe 248
 Adresa e Pasurisë MBYET
 Lloji i Pasurisë ARE+TRUALL
 Sipërfaqja Totale 4519.00 m2
 Nga kjo : Sa Truall 1,280.00 Nga kjo : Sa Ndërtesa 451.80
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
REXHEP	MUHAREM	HOXHAI	1/2	PORTEZ
SHIYQYRIE	KOVAÇ	HOXHAI	1/2	PORTEZ

- është pronar i _____ tek pasuria me numër 62/100
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart _____
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
- kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 29/9/2017 Nr. 28433

Data e lëshimit të çertifikatës
20/7/2018

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI

PETRIT KANANI

KUADRI LIGJOR

Ne vijim te raportit do te njihemi me ligjet baze te cilat detyrojne me forcen ligjore mbrojtjen e mjedisit. Subjeti zhvillues eshte ne zbatim te hapave ligjore.

- Ligji Nr. 10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit" i ndyshuar
Ligji Nr. 52/2020, per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10 448, date 14.7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar.
- Ligji Nr. 10440, date 23/01/2003 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"
Ligji Nr. 12/2015 date 26.2.2015 Per disa ndryshime ne ligjin nr. 10 440, date 7.7.2011, "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"
- Ligji Nr. 10448, date 14/07/2011 "Per lejet e mjedisit",
Ligji Nr.8897, date 16/05/2002 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja"
Ligji Nr.9774, date 12/07/2007 "Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis"
Ligji Nr.9010, date 13/02/2003 "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta"
Ligji Nr.9587, date 20/07/2006 "Menaxhimin e integruar te burimeve ujore "
Ligji Nr. 10081, date 23.02.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise", ndyshuar me ligjin nr.10.137, date 11.05.2009.
- Ligji Nr. 8405, date 17/09/1998 "Per urbanistiken" ndryshuar me ligjet Nr. 8453, date 04/02/1999 dhe Nr.8991, date 23/01/2003 dhe Nr.8682, date 07/11/2000"
Ligji Nr. 8652, date 31/07/2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore."
Ligji Nr. 9244, date 17/06/2004 "Per mbrojtjen e tokes bujqesore"

Vendime te Keshillit te Ministrave (VKM) dhe udhezime

- VKM Nr.249, date 24.04.2003 "Per miratimin e dokumentacionit per leje mjedisore dhe te elementeve te lejes mjedisore"
VKM Nr.268, date 24.04.2003 "Per certifikimin e specialisteve, per vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe te auditimit mjedisor."
VKM Nr.805, date 4.12.2003 "Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis, per te cilat kerkohet Leje Mjedisore.
VKM Nr.24, date 22.01.2004 "Per veprimtarine e inspektoriatit te mjedisit"
VKM Nr.177, date 31.03.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret.
VKM Nr.686, date 29.7.2015 per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (vnm) dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore.

Udhezim i Ministrit te Mjedisit Nr.3, date 17.08.2004 "Per miratimin e listes se veprimtarive, formatimin e aplikimit, dhe rregullat e procedurat e dhenies se pelqimit dhe autorizimit mjedisor nga ARM.

Rregullore e Ministrise se Mjedisit Nr.1, date 17.08.2004 "Per pjesemarrjen e publikut ne procesin e vleresimit te ndikimit te mjedis."

Udhezimi i Ministrit te Mjedisit Nr.5, date 28.12.2007 "Per tarifat e sherbimit per Leje Mjedisore.

Udhezimi Nr.6, date 27.12.2006 "Per miratimin e metodologjise se vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie."

Udhezim i Nr.2, date 21.05.2007 "Per miratimin e listes se veprimtarive me ndikim ne mjedis, menyren e aplikimit dhe rregullat e provedurat e dhenies se autorizimit dhe pelqimit mjedisor nga Agjencite Rajonale te Mjedisit."

Udhezim i Ministrit te Mjedisit Nr.1, date 07.01.2008 "Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar leje mjedisore.

Urdher i Ministrit te Mjedisit, Nr.429, date 17.11.2009 "Per rregullat dhe procedurat per pajisjen me leje mjedisi ne kuader te Qendres Kombetare te Licensimit.

Gjate vitit 2011, jane miratuar edhe tre ligje te rendesishme per mjedisin:

Ligji Nr. 10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit"

Ky ligj eshte plotesisht i perafruar me Direktiven 2004/35/KE te Parlamentit Europian dhe Keshillit, date 21 Prill 2004 "Mbi pergjegjesite mjedisore, parandalimin dhe riparimin e demeve te mjedisit" te ndryshuar"

Ligji Nr.10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"

Ky ligj eshte perafruar plotesisht me Direktiven 85/337/KEE te Keshillit, date 27 Qershor 1985 "Mbi vleresimin e efekteve te projekteve publike dhe private ne mjedis", te ndryshuar.

Ligji Nr. 10448, date 17.07.2011 "Per Lejet e Mjedisit" Ky ligj eshte perafruar plotesisht me

Direktivat:

2008/1/KE e Parlamentit Europian dhe Keshillit e 15 janarit 2008 "Mbi kontrollin dhe parandalimin e integruar te ndotjes", e ndryshuar

Direktiven 2001/80/KE e Parlamentit Europian dhe Keshillit e 23 Tetorit 2001 "Mbi kufizimin e shkarkimeve te disa ndotesve ne ajer nga instalimet e medha me djegie"

Te tre keto ligje nuk kane hyre ende ne fuqi pasi eshte duke u pergatitur aktet e nevojshme nenligjore.

Keto tre ligje hyjne ne fuqi ne Shkurt te vitit 2013

PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Qellimi i ketij aktiviteti eshte rritja intesive e zogjve.

Kompleksi ne te cilen zhvillohet aktiviteti perbehet nga:

- Zyrat e administrates
- Peshorja elektronike
- Shesh per parkimin e automjeteve
- Vend roje
- Stalla per rritjen e zogjeve

Kapaciteti 3000-4000 zogj (pula dhe gjel deti)

Lendet ndihmese jane:

- ✓ ushqimi per zogj (30 ton) ku perfshihet misri, soja, nukleusi,
- ✓ gazi per ngrohje,
- ✓ uji,
- ✓ energi elektrike,
- ✓ gelqere,
- ✓ dezinfektat, etj.

Numri i personave te punesuar 2 punonjes + administratori

Puna per rritjen e zogjeve eshte e organizuar me turne duke i monitoruar zogjte per ushqim dhe per te gjitha proceset e tjera per 24 ore.

PROCESET E RRITJES SE ZOGJEVE

- **Njohja me ambjentin ne te cilin rritet zogu**

Ambienti me te cilin rritet zogu eshte nje lokal perreth. Per te plotesuar kushtet e rritjen e zogjve ne lokale eshte vendosur nje impiant uji perbere nga tre linja uji, nje impiant per ushqimin e zogjeve i perbere nga dy linja ushqimi te kompeltuara me pjata dhe me panelin e komanduar automatik, disa linja me ndricues, ventilatoret per qarkullimin e ajrit, aparati i matjes se temperatures dhe paneli elektrik i kontrollit me anen e te cilit behet komandimi ne menyren e duhur e te gjitha proceseve.

- **Pergatitja e lokalit per prritjen e zogjeve**

Etapa e pare e pergatitjes se lokalit eshte pastrimi i tij nga mbetjet (plehu) e tufes se pare, me pase behet larja e lokalit, proces te cilit i kushtohet nje rendesi e vecante. Lokali pasi eshte pastruar dhe lare lihet te thahet per disa dite, me pas behet izolimi, mbyllja e dritareve, dyerve, aspiratoreve ne menyre qe denzifektimi te behet sa me mire dhe te japi rezultate sa me pozitive.

Pasi kan mbaruar keto procese behet dezinfektimi i ambientit ne menyre te imtesishme dhe ne sasine e duhur te dezinfektantit dhe lokali lihet i mbyllur 24 ore. Pas kesaj behet shtrimi i lokalit, i cili behet ne fillim me nje shtrese te holle gelqereje e cila sherben per asgjesimin e ndonje mikrobi qe mund te kete ngelur dhe thithjen e lageshtires. Shtresa e dyte perbehet prej tallashi, ka nje trashesi prej 3-4 cm dhe hapet ne menyre uniforme ne te gjitha lokalin. Me pas ne lokal futen materialet e nevojshme si pjatat e ushqimit, pireset e ujit dhe fibrat per berjen e rrethakeve, montohen linjat e ushqimit dhe pastrohen linjat e ujit ne menyre qe ne rritjen e zogut gjithcka te jete gati.

Etapa e fundit e pergatitjes se lokalit eshte furnizimi, denzifektimi me perzierje formaline dhe permanganate, pas kesaj lokali lihet perseri i mbyllur per te pakten 24 ore. Eshte per tu theksuar fakti qe koha e qendrimit bosh te lokalit midis dy intervaleve te rritjes se zogjeve duhet te jete te pakten 2 jave.

- **Pritja e zogut**

Duke u mbeshtetur dhe tek kushtet klimaterike hapja e lokalit behet 1 ose 2 dite para mberitjes se shpendeve. Gjate kesaj kohe behet ngrohja e lokalit me ane te ngroheseve qe jane kryesisht me gaz, pergatitja e rrethakeve dhe vendosja e piresve te ujit dhe kupave te ushqimit brenda ne rrethak. Gjithashtu behet larja e linjave te ujit dhe me pas ato lihen te mbushura , uje me sode gje e cila ndihmon ne pastrimin e linjave te ujit dhe ne heqjen e mbeturinave. Arsyeja e krijimit te rrethakeve eshte arritja e temperatures e cila posht ngrihesit ne castin e mbritjes se zogut duhet te jete 30-33°C. Ne momentin e mbritjes, zogut nuk i hidhet ushqim por vetem uje i cili eshte hedhur ne prerese gjysem ore para mbritjes se zogut. Kjo behet me qellim qe zogu mos te ndiej ndryshimin e temperatures se ambientit me ate te ujit. Me pas rreth 90 min me vone zogut i hidhet ushqimi i cili eshte i bluar imet gati si miell. Transporti i zogut behet me makina te pershtatshme ne menyre qe temperatura te jete ne normen e duhur. Çdo ndryshim temperature ndikon ne rritjen e zogjeve, pra makinat jane te pajisura me sistem ngrohje dhe ventilimi.



Foto 1 Ambientet e brendshme te lokalit ku rriten zogjte

- **Pershtatja e aparaturave sipas moshes se zogjeve**

Ne ditet e para zogu ushqehet si e permendem me siper. Rreth dites se trete zou hiqet nga rrethakja dhe uji thithet ne menyre automatike me ane te linja te ujit duke lene disa pirese shites, ndersa zogu te pije uje ne linja. Menyra e ushqimit vazhdon e njejte si ditet e pare deri ne moshen 10-15ditesh, me pas vendosen linjat automatike te ushqimit. Pra zogu ushqehet sipas deshires. E rendesishme ne rritjen e tyre eshte temperatura dhe ventilimi. Ne ditet e para temperatura do te jete rreth 32°, me pas kjo temperature ulet me 2° gjate nje jave. Ky ndryshim behet gradualisht. Per te patur nje informacion te sakte mbi rritjen e zogjve çdo jave behet peshimi i zogjeve duke mare nje peshe mesatare. Ne lokal gjithashtu duhet te kete nje qarkullim te ajrit dhe pastrim te ambientit. Kjo realizohet me ane te dritareve por edhe te aspiratoreve. Kur arrin moshen 5-7 ditesh ne lokal vendoset ventilimi automatik i cili arrihet duke lidhur aparatin e temperatures me aparatin e ventilimit ne kete menyre ventilatoret vihen ne pune vetem kur temperatura kalon mbi temperaturen qe i nevojitet zogut dhe punojne deri sa te arrihet temperatura e deshiruar. Uji hidhet ne pirese dhe nderohet disa here ne menyre qe te mos arrij temperaturen e ambientit. Kjo menyre perdoret vetem 4-5 ditet e para. Me pas zogu hapet ne te gjitha lokalit dhe vihen ne funksion linjat e ujit me ane te cilave qarkullon uji i rrjedhshem. Per te mos lejuar ngrohjen e ujit ne fund te linjes jane vendosur tuba me rrjedhje jashte lokalit ne menyre qe qarkullimi te jete sa me i madh. Ne kete menyre uji mbahet ne nje temperature normale.

- **Pergatitja e ushqimit dhe perberesit kryesor te tij**

Nje pike e rendesishme ne realizimin me sukses te kesaj veprimtarie eshte edhe ushqimi. Perberesit kryesor jane misri dhe soja. Rreth 60% te ushqimit e perbene misri , soja perbene 37% dhe pjesa tjeter perbehet nga vaji, karbonat dhe mukleusi qi i nevojitet zogut per te marr sasine e duhur te proteinave, energjise dhe gjithcka qe i nevojitet per nje rritje pa probleme. E rendesishme nuk eshte vetem perberja e ushqimit por dhe madhesia e kokrres se ushqimit. Ne periudhen e pare deri ne 21 dite kokrra e ushqimit duhet te jete shume e vogel , me pas ushqimi behet me i ashper ne menyre qe zogu mund ta konsumoj pa probleme. Pergatitja e ushqimit bluarja dhe perzierja, behen ne nje kapanon i cili ndodhet ne te njejtin territor. Ne kete kapanon ndodhet nje bluares mulli dhe nje perzieres, gjate ketij procesi duhet patur parasysh qe imtesia e kokrres se ushqimit dhe koha e perzierjes te jete e duhura. Zogu ushqehet dite-nate me perjashtim te dy ose tre oreve gjate nates, kohe e cila varet nga mosha e zogut.



Foto 2 Makineria e pergatitjes se ushqimit

- **Rregullat per mbrojtjen nga faktoret e jashtem**

Rendesi e vecante i kushtohet mbrojtjes nga faktoret e jashtem per kete perdoret ajo qe quhet karantine, domethene nuk lejohet kalimi i punetoreve dhe materialeve te ndryshem. Nuk lejohet hyrja e makinerive te huaja ne territorin e kompleksit. Makinat perpara se te futen ne kete ambient u behet dezinfektimi me sperkatje. Per kete ne hyrjen e jashteme te ambientit dhe ne hyrje te cdo lokali eshte vendosur ne grope ne te cilen hidhet uji me perqindjen e duhur te dezinfektantit ne menyre qe cdo kush qe hyne ne lokal te mund te dizinfektoje kembet.

- **Programi i mbareshtimit te zogjve**

Zogjte mbareshtohen sipas nje programi zooteknik-veterinar te perpiluar nga specialiste perkates.

Ky program mbeshtet ne keto pika:

- ✓ Norma e ventilimit te lokalit
- ✓ Normat e ushqimit sipas fazes se rritjes se zogjve
- ✓ Pershtatja e temperatures sipas moshes se zogjeve
- ✓ Programi i vaksinimeve. Me ane te vaksinimit parandalohen semundjet kryesore qe qarkullojne.
- ✓ Perdorimi i medikamenteve te ndryshme, me ane te te cileve luftohen infeksionet e mundshme.

Subjekti “Hoxhaj” sh.p.k ben nje riciklim te mbetjeve qe vijne nga shpendet qe mban ne kompleksin blegtoral. Te gjitha mbetjet e ketyre shpendeve perdoren si pleh organik ne aktivitete te tjera bujqesore qe subjekti ka ne zoterim.



Foto 3 Ambjentet e jashteme te lokalit ku rriten zogjte

Infrastruktura e nevojshme

- ✓ Subjekti “Hoxhaj” sh.p.k e merr energjiine elektrike nga rrjeti elektrik kryesor i Njesise Administrative Portez nepermjet kontrates B-054543 qe ka nenshkuar me Operatorin e Shperndarjes se Energjise Elektrike SH.A. Kjo energji sherben per ndricimin e ambjenteve te lokalit dhe ambjeneteve te tjera te aktivitetit duke krijuar kushte te pershtateshme per rritjen e zogjve. Sasia e energjise qe konsumohet mesatarisht ne muaj eshte 232 kw.
- ✓ Furnizimi me uje kryhet nga rrjeti kryesor i furnizimit me uje te pijshem nepermjet kontrates Nr.1470 qe subjekti ka nenshkuar me Ujesjelles- kanalizime Fier. Sasia e ujit qe konsumohet per kete aktivitet eshte mesatarisht 500-1000 litra/dite. Uji perdoret per pirje per zogjte duke ju permbajtur te gjitha kushtet higjenike dhe temperatures per rritjen normale te tyre.

KONTRATË PËR SHËRBIMET UJËSJELLËS - KANALIZIME FIER

#95150167#

NDERMJET

№ 1470

Sh. a UK Fier i quajtur "Operatori" pajisur me licensë të ushtrimit të aktivitetit nga ERRU, nr. 2 datë 22/01/2014 përfaqësuar nga _____, me adresë në rrugën Shën Gjergji Adresa postare Lagja "1 Maj" Nr telefoni/Fax _____, adresë elektronike info@ukf.al dhe faqe elektronike www.ukf.al

DHE

Konsumatorit si më poshtë

KONSUMATOR PRIVAT	TË DHËNA PËR UJËMATËSIN
Emri tregtar <i>"MOXHAJ" shpk</i>	Data e instalimit <i>12.01.2012</i>
NR NIPT <i>K526194018</i>	Vendi i instalimit
Përfaqësuesi i autorizuar <i>Rexhep Hoxha,</i>	Numri i Ujëmatësit <i>87205378</i>
Numri i Telefonit/Fax <i>0077031307</i>	Kapaciteti i Ujëmatësit
Adresa <i>Mbyet</i>	Numri i Modelit
Adresa Postare	Vendi i Prodhimit
Shërbimet që ofrohen	Jetegjatesia
Vetëm furnizimi me ujë <input checked="" type="checkbox"/>	Vetëm grumbullim, largim dhe përpunim të ujrave të ndotura <input type="checkbox"/>
	Furnizimi me ujë dhe grumbullim, largim dhe përpunim të ujrave të ndotura. <input type="checkbox"/>

Duke nënshkruar këtë kontratë, përfaqësuesit e autorizuar të palëve kanë rënë dakord për sa më poshtë:

- Kjo kontratë përbëhet nga Kushtet e Përgjithshme dhe Aneksi 1, dhe bazohet në legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- Fatura e lëshuar nga Operatori për shërbimet e ofruara përbën "Titull Ekzekutiv" sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- Konsumatori bie dakord për detyrimet ndaj Operatorit, taksat dhe tatimet në fuqi në momentin e nënshkrimit të Kontratës dhe ndryshimet që mund të pësojë Kontrata gjatë kohëzgjatjes së saj.
- Nëse Konsumatori nuk kryen pagesën e Faturës brenda datës 28 të muajit pasardhës, ai duhet të paguajë kamatvonesën prej 0,5 % të vlerës së fatures për çdo ditë vonese, por jo më shumë se 10% të vlerës së fatures.
- Në rast mospagese brenda 30 ditëve kalendrike pas afatit të mesiperm, Operatori ka të drejtë të ndërprejë furnizimin me ujë vetëm pasi ka njoftuar me shkrim konsumatorin të paktën 5 ditë kalendrike përpara.
- Pagesa do të bëhet në _____
- Çdo konsumator ka të drejtën të bëjë kërkesë/ankesën pranë zyrave të Operatorit.
- Kontrata hartohet në 2 kopje dhe secila nga palët mban një kopje.

PËR OPERATORIN :

Emri: _____
Nënshkrimi/vula: _____
Data: (d/m/V): _____
Konc: _____
Konc: _____
Konc: _____
Aleksander Brahuçi

PËR KONSUMATORIN:

Emri: *"MOXHAJ" shpk*
Nënshkrimi/vula: *Rexhep Hoxha*
Data: (d/m/V): _____





Foto 4 Depozita e ujit

- ✓ Ujrat te cilat dalin nga larja e ambjenteve te lokalit ku rriten zogjte te cilat kane permbajtje te ulet te fekaleve te zogjve te cilat kane ngel gjate procesit te grumbullimit te tyre per pleherimin e tokes. Keto ujera pasi grumbullohen nga sistemi i tubacioneve qe ka ndertuar subjekti bashke me ujrat qe dalin nga ambjentet higjeno-sanitare shkarkohen ne gropen septike te ndertuar sipas kushteve teknike brenda koordinatave kufizuese te pasurise qe zoteron subjekti. Gropa e septike eshte mbyllur hermetikisht duke shmangur aromat e pa kendeshme dhe pastrohet periodikisht nga kompanit e pastrimit te cilat meren me menaxhimin e ujrave te ndotura. Ujra e shiut nepermjet pjerresise se terrenit me vetrrijedhje shkojne ne kanalin kullues te zones i cili ndodhet ne konturet e prones ku eshte ndertuar objekti i rritjes intensive te zogjve.



Foto 5 sistemi i tubacioneve te grumbullimit te ujrave te pastrimit



Foto 6 Gropa septike

SHKARKIMET NE MJEDIS

Duke vleresuar gjendjen e mjedisit ne zone si dhe treguesit cilesor te tij, nga zhvillimi i ketij aktiviteti sipas kushteve teknike dhe higjeno-sanitare, theksojme se nqse do te kryhet menaxhimi i duhur i mbetjeve, ujrave qe gjenerohen, aromat e pakendeshme, etj, ky aktivitet nuk ka ndikim ne mjedis mbi normat e lejuara te shkarimeve ne mjedis. Me poshte paraiten shkarkimet ne mjedis dhe menaxhimi i tyre nga subjekti.

Shkarkimi i ujrave

Ujrat qe gjenerohen nga zhvillimi normal i aktivitetit, nuk permbajne lende apo substanca te klasifikuara te rrezikeshme nga legjislacioni perkates ne fuqi.

- ✓ Ujrat te cilat dalin nga larja e ambjenteve te lokalit ku rriten zogjte te cilat kane permbajtje te ulet te fekaleve te zogjve qe kane ngel gjate procesit te grumbullimit te tyre per pleherimin e tokes. Keto ujera pasi grumbullohen nga sistemi i tubacioneve qe ka ndertuar subjekti bashke me ujrat qe dalin nga ambjentet higjeno-sanitare shkarkohen ne gropen septike te ndertuar sipas kushteve teknike brenda koordinatave kufizuese te pasurise qe zoteron subjekti. Gropa e septike eshte mbyllur hermetikisht duke shmangur aromat e pa kendeshme dhe pastrohet periodikisht nga kompanit e pastrimit te cilat meren me menaxhimin e ujrave te ndotura.
- ✓ Ujra e shiut nepermjet pjerresise se terrenit me veterrdhje shkojne ne kanalin kullues te zones i cili ndodhet ne konturet e prones ku eshte ndertuar objekti i rritjes intesive te zogjve.

Shkarkimi i mbetjeve

Nga zhvillimi i aktivitetit te permendur me siper nuk shkarkohen mbetje te rrezikshme.

- ✓ Mbetjet qe gjenerohen nga procesi i rritjes se zogjve, ku perfshihen mbetje nga ushqimet dhe glasat e tyre ne momentin e grumbullimit, transportohen direkt drejt fermereve te zones te cilet e perdorin perdorin si pleh organik per pleherimin e tokave. Largimi i menjehershem i ketyre mbetjeve nga ambjentet e lokalit ku rriten zogjte drejt destinacionit te kerkuar te fermereve shmang krijimin e mbetjeve te depozituara ne ambejtet e aktivitetit si dhe aromat e pa kendeshme qe mund te krijohen nga prania e tyre. Transporti i tyre kryhet nga automjetet personale te fermereve sipas kushteve teknike duke shmangur derdhjen dhe rrjedhjen e tyre ne rrugen qe pershkojne.
- ✓ Mbetjet nga procesi jetesore i punonjesve edhe pse ne sasi te pakta, duke qene se jane me natyre urbane pasi grumbullohen ne ambjentet e aktivitetit depozitohen ne vendgrumbullimin me te afert te mbetjeve urbane te zones.

Shkarkime ne ajer

Shkarkimet ne ajer qe do te gjenerohen nga ky aktivitet jane brenda normave te lejuara pasi subjekti i ndjek me rreptesi masat per minimizim e tyre.

- ✓ Shkarkime ne ajer do te kemi te pranishme gjate procesit te transportit te lendeve te para dhe mbetjeve teknologjike, nga djegja e karburantit ne motor te automjeteve qe bejne te mundur transportin e tyre. Keto shkarkime jane brenda normave te lejuara dhe nuk ndikojne ne prishjen e cilesise se ajrit.
- ✓ Shkarkime te aromave te pakendeshme ne ambientet e lokalit nga rritja intesive e zogjve, nga prania e glasave. Keto aroma te pa kendeshme minimizohen duke kryer pastrimin dhe ajrimin periodik te mbetjeve dhe ajrit ne ambientet e lokalit.
- ✓ Shkarkime te pluhurave nga levizja e zogjve brenda ambjenteve te lokalit. Subjekti ka mar masa duke i sperkatur vazhdimisht ambientet per eleminimin ne maksimum te tyre.

MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT

Identifikimi i masave per te eliminuar apo zbutur ndikimet negative ne mjedis

a) Planifikimi i zones

Zhvillimi i aktivitetit kryhet sipas radhes se proceseve te rritjes intesive te zogjve, grumbullimin e mbetjeve, diferencimin e tyre sipas perberjes dhe transportin e tyre drejt destinacionit perkates.

Rreth ketij objekti, toka eshte e mbjelle me ullishte te cilat shfrytezohen per tregeti dhe sherbejne dhe per pastrimin e ajrit dhe zbuturimin e ambientit te jashtem te lokalit.

Propozohet qe ne kufijt e pronesis se mbidhet nje brez i larte pemesh (lejlandra) ne menyre te tille qe te kufizohet aktiviteti nga objektet e tjera perreth dhe shmangien e pluhurave dhe aromave te pa kendeshme ne objektet me te aferta.

b) Masat teknike

Per nje ecure sa me te mire te proceseve te rritjes se zogjve, subjekti parashikon cdo vit te kryej punimet e meposhtme:

- Remot te plote te makinerise qe kryen procesin e pergatitjes se ushqimit.
- Pastrim, lysterje dhe riparim te mjediseve te brendshme dhe te jashteme te lokalit ku rriten zogjte.
- Pastrimi periodik i sistemit te tubacioneve te ujit qe furnizojne lokalin per pirjen e ujit nga zogjte, ne menyre te tille qe te ofrohet uje sipas paramtrave dhe standarteve te lejuara per pirje.
- Ventilimi dhe ajrimi periodik i ambienteve duke krujuar kushtet e caktuara te rritjes se zogjve ne ambientet e lokalit.
- Kontolli veterinar dhe vaksinimi periodik i zogjve.
- Mbajtja e temperaturave ne vlerat e duhura ne ambientet e lokalit.
- Sistemime e rregullime dhe mbjellje fidanesh te rinj ne pjeset anesore te sheshit.

c) Masat estetike dhe ekologjike

Gjate ushtrimit te ketij aktiviteti subjekti do te kryej proceset e meposhtme:

- Ruajtjen e rrethimit te objektit
- Sistemimin e mbetjeve qe dalin nga procesi i rritjes intesive te zogjve dhe transportin e tyre drejt destinacionit perkates.
- Levizjen e automjeteve te transportit brenda objektit ne menyre te kontrolluar dhe pa krijuar remuje ne oborr.
- Krijimin e kushteve te pershtatshme per te mbjelle dhe kultivuar bime dhe peme te ndryshme.

d) Masat konkrete per administrimin e mbetjeve te ngurta

Aktiviteti i rritjes intesive te zogjve ne nje instalim, per administrimin e mbetjeve qe do te gjenerohen, duhet te marre keto masa:

- Mbetjet dalin nga punonjesit, duhet te largohen ne menyre korekte nga ambientet e punes dhe te dergohen drejt destinacionit perkates.
- Mbetjet me natyre organike qe do te dalin gjate procesit te rritjes intesive te zogjve (jashteqitja dhe mbetje ushqimi) duhen te grumbullohen dhe te transportohen direkt drejt destinacionit te percaktuar nga fermeret e zones te cilet jane te interesuar per pleherimin e tokave.

e) Masat konkrete per mbrojtjen e cilesise se ajrit

Me qellim qe shkarkimet ne ajer qe emeton aktiviteti i rritjes intesive te zogjve te jene vazhdimisht brenda normave te lejuara duhet te merren keto masa:

- Ambientet rreth e rrotull aktivitetit duhet te sperkaten me uje ne menyre te tille qe kur te vijne dhe te largohen makinat e transportit te lendes se pare dhe plehut te mos ngrihen pluhura (keto jane te vetme pluhura qe gjenerohen nga aktiviteti).
- Te kryhet ventilimi i ambjenteve te lokalit dhe largimi i menjerhershem i glasave ne menyre periodike per te shmangur aromat e pa kendeshme.
- Te mbillet nje breze i gjelber perreth parceles se aktivitetit duke izoluar objektin nga pjesa tjeter e zones, dhe per pastrimin e ajrit nga pluhurat dhe aroma e pakendeshme.

Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbatuese

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjitha treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permirsimi i vazhdueshem, sipas kushteve teknike te punes ne zbatim te projektit, qe do te coje perfundimisht perfitimin e pamjeve te parashikuar ne projekt me siperfaqe te brendshme te sistemuara dhe me oborr te gjelberuar aty ku do te kete hapsira te lira.

Plani i emergjencave

Plani i emergjencave eshte nje nder planet kryesore me qellim parandalimin dhe mbrojtjen e jetes dhe shendetit te punonjesve, komunitetit dhe mbrojtjen e mjedisit.

Personeli i ketij projekti duhet te njohe mire te gjitha proceset qe kryhen ne kete aktivitet ne menyre qe te arrije te kuptoje situaten, shkaqet dhe te jete i pergatitur per menaxhimin e avarive apo aksidenteve. Ne rast se gjendemi para nje aksidenti personat me te afert duhet te japin shenjen e alarmit. Ne varesi te llojit dhe madhesis se aksidentit do te kryhet izolimi.

Masat per parandalimin e avarive dhe aksidenteve ne frontin e punes jane:

- Perdorimi i mjeteve dhe paisjeve te cilat jane ne gjendje te mire teknike
- Servisim periodik i mjeteve dhe instalimeve te tjera ne frontin e punes
- Çdo person para se te nisi punen ne kete projekt ti nenshtrohet trajnimit per te njohur gjithë procesin teknologjik, per tu njohur me rrezikun e aksidenteve dhe reagimin e tij ne cdo rast emergjent.
- Ne objekt te ndertohet kendi i ndihmes se shpejte dhe te jete i njohur nga te gjithë personat e punesuar.
- Ne objekt te vendosen tabela/njoftime ku tregohen pikat kyçe te rrezikut, te publikohen numrat e kontaktit te emergjencave.
- Zona te jete e rrethuar per te evituar hyrjen e personave te pa autorizuar.
- Te jete ndertuar sistemi i tokezimit

Trainimi i Personelit

- Trainimi do te mbuloje aspektet e shendetit dhe sigurise gjate kryerjes se proceseve te punes. Trainimi mjedisor do ti referohet kushteve aktuale mjedisore, ndikimeve potenciale mjedisore te punes qe do te behet dhe zbatimit te masave specifike parandaluese per eliminimin apo minimizimin e ndikimeve negative.
- Nje plan trainimi do te zhvillohet per te siguruar se personeli perkates ka marre trainimin e duhur dhe kompetencat per kryerjen e punes se tij.

Subjekti eshte i detyruar qe ne rast aksidentesh te njoftoje institucionet perkatese per menaxhimin e situatave me qellim zvogelimin e impakteve mjedisore dhe rrezikut qe mund te preke jeten e punonjesve apo dhe banoreve.

MONITORIMI

Monitorimi eshte procesi i vzhgimit dhe mbledhjes se te dhenave ne menyre periodike ose te vazhdueshem mbi fenomenet natyrore qe zhvillohet ne objekt, si pasoje e ushtrimit te veprimtarise se mesiperme.

Per realizimin e monitorimit, personat fizik dhe juridike specializojne punonjesit e tyre ose kontraktojne me institute te specializuara. Vetmonitorimi i veprimtarise realizohet ne baze te programit individual te monitorimit dhe ne perputhje me kerkesat e Programit Kombetar te Monitorimit.

Programi i vetmonitorimit te subjektit duhet te trajtoje ceshtjet e meposhteme:

- ✓ Monitorimi i ndikimeve te veprimtarise ne mjedisin perreth dhe elementet e tij.
- ✓ Monitorimi i menyres se zbatimit te kushteve te lejes mjedisore
- ✓ Monitorimi i ecurise se realizimit te masave te rehabilitimit dhe efektivitetit te tyre.

Duke u bazuar ne lejen mjedisore ekzistuese, subjekti kryhen vetmonitorimin ne aktivitetin e rritjes intesive te zogjve, cdo 6 muaj sic eshte percaktuar ne kushtet e lejes. Vetmonitorimin subjekti e dorezon prane ARM-se.